



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Departamenti për Profesione të Lira-Departmant Slobodnih Profesija- Department of
Freelance Professions

Komisioni Disiplinor/Disiplinska Komisija/The Disciplinary Comitee

DPL.nr.07/2023

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT, në përbërje nga Manushe Karaçi kryesuese, Adnan Konushevi dhe Rushit Hoxha, anëtarë të komisionit disiplinor për përmbarduesit privat, në çështjen disiplinore ndaj përmbarduesit privat, si organ përmbardues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës për Territorin e Gjykatës Themelore lidhur me veprimet përmbardimore në lëndën përmbardimore, P. nr. 08/2023, pas mbajtjes së seancës dëgjimore publike, në të cilën ka prezantuar përfaqësuesja e Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbardimin Fadilete Hoxha - Blakqori, pala ankuese, me seli në Prishtinë, me përfaqësues dhe Përmbarduesi Privat, me datën 14.04.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. REFUZOHET Raporti përfundimtar i Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbardimin Privat, DPL-07/2023 i datës 07.02.2023, dhe ankesa e paraqitur nga pala ankuese, me seli në Prishtinë, e datës 03.02.2023, **si te pa bazuara.**

II. Përmbarduesi Privat si organ përmbardues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës për Territorin e Gjykatës Themelore **nuk është përgjegjës** për shkelje të pretenduara disiplinore gjatë veprimeve të ndërmarra në lëndën përmbardimore P. nr. 08/2023.

A r s y e t i m

Me datën 03.02.2023, pala ankuese ka paraqitur ankesë në Ministrinë e Drejtësisë ndaj Përmbarduesit Private, pranë të cilës ka mbetur edhe në seancën dëgjimore, me të cilën pretendon

se përmbaruesi privat, ka bërë shkelje me rastin e lejimit të përmbarimit në rastin P.nr.08/2023, pasi që në këtë rast është kompetencë ekskluzive që e ATK-së, që ta bënë ekzekutimin e përmbarimit lëndor e jo i përmbaruesit, në kuptim të nenit 147 të LPPA-së. Me propozim për komisionin që të aprovohet ankesa dhe të ndermirën masa ndaj përmbaruesi privat.

Me datën 07.02.2023, Ministria e Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, ka paraqitur në Komision Raportin për Përfundimtar ndaj përmbaruesit privat, lidhur me veprimet përmbarimore në këtë rast.

Përmbaruesi privat në përgjigjen në ankesë dhe seancën dëgjimore të mbajtur me datë 14.04.2023, e ka kundërshtuar në tërësi si raportin e ministrisë së drejtësisë ashtu edhe pretendimet e palës ankuese, duke pretenduar që asnjë dispozitë ligjore nuk është shkelur në rastin konkret. Poashtu ka shtuar se nga organi përmbarues madje as në raport, ministria e drejtësisë nuk e ka theksuar ndonjë dispozitë ligjore e cila është shkelur nga organi përmbarues. Më tutje përmbaruesi ka theksuar, se përmbarimi është lejuar në bazë të dokumentit të besueshëm – vendim të organit administrativ, i cili i ka plotësuar të gjitha kushtet ligjore për lejimin e përmbarimit. I ka propozuar komisionit disiplinor që të refuzohet si raporti i ministrisë së drejtësisë ashtu edhe ankesa e palëve ankuese si të pabazuara.

Me datën 14.04.2023, Komisioni Disiplinor, pas seancës dëgjimore dhe dëgjimit të palëve, me kujdes dhe vëmendje ka vlerësuar të gjitha pretendimet e palëve dhe ka çmuar çdo provë të administruar në seancën dëgjimore veç e veç dhe të gjitha ato së bashku, ashtu që erdhi në përfundim që organi përmbarues në këtë rast, nuk është përgjegjës për shkelje disiplinore.

Komisioni Disiplinor vlerësoi pretendimet e palës ankuese, janë të pa qëndrueshme sepse përmbaruesi privat e ka lejuar përmbarimin në bazë të dokumentit të besueshëm-vendimit administrativ, sipas nenit 22 paragrafi 1 nën paragrafi 2 i LPP-së, përcaktohet si dokument përmbarimor vendimi përmbarues i dhënë në procedurë administrative përfshirë edhe organin administrativ siç është në këtë rast Inspektorati i Punës. Duke ju referuar edhe dispozitës ligjore të nenit 147 të LPPA-së, i cili përcakton detyrimet financiare që burojnë nga aktet administrative, është në kompetencë të Administratës Tatimore, për veç kur parashikohet ndryshe me ligj. Që në rastin konkret është përcaktuar ndryshe më ligj sipas nenit 22 paragrafi 1, nën paragrafi 2 dhe nenit 23 paragrafi 2 i LPP-së, ku përcaktohet kompetenca e organit përmbarues për ekzekutimin e vendimeve administrative siç edhe është përmbaruar në këtë rast nga përmbaruesi privat. As raporti përfundimtar i Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, dhe as pretendimet e palëve ankuese nuk ishin bindëse se

organi përmbaues ka bërë ndonjë shkelje disiplinore ku në mënyrë taksative janë të përcaktuara shkeljet disiplinore për përmbauesit privat në bazë të nenit 367, paragrafi 1, nën paragrafët nga 1 deri 11 të Ligjit të Procedurës Përmbaimore (LPP). Për këto arsye dhe në mungesë të provave, komisioni disiplinor nuk ka gjetur asnjë arsye për të vendosur ndryshe në këtë rast.

Mbi bazën e të dhënave si më lart, Komisioni Disiplinor bazuar në nenin 370, paragrafi 1, lidhur me nenin 374 të Ligjit për Procedurën përmbaimore, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT

DPL.nr 06/2023 datë 14.04.2023



Kryesuesja e Komisionit Disiplinor
Manushe Karaçi

Manushe Karaçi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë të hap konflikt administrativ bazuar në nenin 374, par 5 të LPP-së, brenda 30 ditëve nga data e pranimit të këtij vendimi.